

KONFERENCAT NDËRKOMBËTARE PËR KOSOVËN

1998-2008

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I SHKENCËS NË HISTORI TË KOHËS SË RE

NGA

BESARTË SOPAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

TETOR, 2022

EKSPOZE E TEMËS
KONFERENCAT NDËRKOMBËTARE PËR KOSOVËN
1998-2008

Mentori:
Prof. dr. Ibrahim **GASHI**

Kandidatja:
Besarta **SOPAJ**

Jam munduar që në këtë punim master të trajtoj çështjen e konferencave ndërkombëtare për Kosovën për periudhën 1998-2008. Pa dyshim, edhe Konferenca e Rambujesë paraqet ngjarjen më të rëndësishme për popullin e Kosovës. Që nga ajo Konferencë, fati i shqiptarëve të Kosovës nisi të ndryshohej në të mirë, populli tani e tutje kishin edhe përkrahjen ndërkombëtare për zgjidhjen e fatit të tyre.

Konferenca Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje dhe në Paris ishte Konferencë Ndërkombëtare për Kosovën, por, në të njëjtën kohë, ishte Konferencë Ndërkombëtare për qëllime që do të kenë shtrirje më të gjerë se ballkanike. Ajo ishte Konferencë Ndërkombëtare për Kosovën, ku do të fillojnë të ndërtohen edhe praktikisht e jo vetëm teorikisht dhe politikisht, themelet e strategjisë politike të Liderit botëror – të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të aleatëve të tij në Paktin Atlantik – të vendeve të Bashkimit Evropian, për shekullin e ardhshëm – shekullin XXI.

Marrëveshja e Rambujesë gati në tërësi është e përmbajtur në Rezolutën 1244 dhe nëse do të elaborohet, shihet se i referohet Marrëveshjes së Rambujesë. Serbët ishin të paralajmëruar nëse nuk e nënshkruajnë marrëveshjen, do të bombardohen, ndërsa shqiptarëve u është thënë se qoftë se dështimi do të vinte për fajin e tyre, atëherë do t'i linin nën mëshirën e forcave të sigurimit dhe paraushtarakëve serbë. Me fjalë të tjera, të dyja palëve u është thënë: ***“Nënshkruaj ose vdis”***.

Pas zhvillimeve e negociemeve të vazhdueshme, më 17 shkurt të vitit 2008, Kosova u shpall shtet i pavarur. Kosova u shpall shtet i pavarur. Deri më tani Kosova është njohur prej më shumë se 100 shteteve dhe është bërë anëtare e dhjetëra organizatave ndërkombëtare.

Qëllimi

Qëllimi i këtij punimi është që të studiohet roli dhe rëndësia e **Konferencës Ndërkombëtare për Kosovën (Konferenca e Rambujesë)**, duke analizuar librat e shkruara nga pjesëmarrësit në këtë konferencë, shtypin e kohës dhe më të vonshëm, si dhe materiale nga interneti.

Pikërisht më 12 qershor të vitit 1999, në Kosovë zbarkuan trupat e para të këmbësorisë së NATO-s, ndërsa ka nisur largimi i forcave serbe. Ndërsa, më 10 qershor 1999, Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana kishte lëshuar urdhrin për ndalimin e bombardimit dhe Këshilli i Sigurimit së OKB-së miratoi rezolutën 1244, ku u dërguan 37.200 ushtarë të KFOR-it nga 36 shtete.

Lidhur me temën që e kam trajtuar kam marrë për bazë literaturë të mjaftueshme, si dhe jam munduar që tema në fjalë të dalë sa më e pasur, në aspektin përmbajtjesor, por edhe me të vërteta. Përveç literaturës së mjaftueshme, kam marrë për bazë edhe burime të tjera, si: *libra universitarë, arkiva, artikuj dhe studime dhe burime online.*

Metodat dhe objektivat e studimit

Në trajtesën e kësaj teme metodat e hulumtimit shkencorë, të cilat janë përdorur që tema në fjalë të jetë sa më përmbajtjesore dhe më produktive dhe sa më afër së vërtetës janë ato: *induktive dhe deduktive, të analizës dhe sintezës, si dhe deskripcionit.*

Ky punim është trajtuar, duke u mbështetur në literaturë, që kishin të bënin me të direkt ose indirekt, nga gazetat e kohës, nga arkivat shtetërore nga literatura, si dhe libra dhe publikimet shkencore në internet.

Organizimi i punimit

Kjo temë masteri është punuar dhe strukturuar në tre kapituj kryesorë të ndarë, si dhe në disa nënkapituj. Secili kapitull trajton çështje të veçanta me synim të përmbushjes së objektivave. Thënë realisht, punimi në fjalë pati një organizim të mirë, për sa i përket punimit në fjalë.

Kapitulli I:

Konferenca e Rambujesë është njëra nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Kosovës. Edhe pse negociatat teknikisht kishin dështuar, politikisht situata është më e komplikuar. Dështimi teknik i tyre kishte mundësuar suksesin politik të kësaj konference për Kosovën. Kësisoj, njëri nga interpretimet më të paqëndrueshme të Marrëveshjes së Rambujesë është ai që thotë se negociatat e Rambujesë kanë qenë dështim për Kosovën. Rambuje ka dështuar vetëm në aspektin formal. Në rrafshin real, ajo ka triumfuar.

Konferenca Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje dhe në Paris ishte Konferencë Ndërkombëtare për Kosovën, por, në të njëjtën kohë, ishte Konferencë Ndërkombëtare për qëllime që do të kenë shtrirje më të gjerë se ballkanike. Ajo ishte Konferencë Ndërkombëtare për Kosovën, ku do të fillojnë të ndërtohen edhe praktikisht e jo më vetëm teorikisht dhe politikisht, themelet e strategjisë politike të Liderit botëror – të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të aleatëve të tij në Paktin Atlantik – të vendeve të Bashkimit Evropian, për shekullin e ardhshëm – shekullin XXI.

Konferenca e Rambujesë është më e rëndësishmja në historinë e shqiptarëve të Kosovës. Është konferenca e parë ndërkombëtare që afirmoi aspiratat e Kosovës për çlirim nga Serbia apo nga ndonjë entitet tjetër. Më 1878 në Konferencën e Berlinit u injoruan kërkesat e shqiptarëve për bashkim në një vilajet. Më 1913 në Konferencën e Londrës u mbrojt pavarësia e Shqipërisë, por Kosova u la nën Serbi. U desh të vinte viti 1999 që të organizohej një konferencë ndërkombëtare e vendeve më të fuqishme që Kosovës t'i mundësohej çlirimi nga Serbia. Edhe pse qëllimi nuk ishte që të respektohej ndonjë e drejtë historike për Kosovën, efektet ishin të tilla. Kosova do të çlirohej nga Serbia. Si e tillë, Konferenca e Rambujesë zë një vend unik dhe të pamohueshëm në historinë e Kosovës.

Shkaku i vërtetë i thirrjes së Konferencës së Rambujesë ishte Masakra e Reçakut, e cila ndodhi më 15 janar të vitit 1999. Durimit i kishte ardhur fundi dhe bashkësia ndërkombëtare, e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian, ndërmorën një aktivitet të shtuar dhe të pakthyeshëm për Kosovën. U organizua Konferenca Ndërkombëtare për Kosovën, në Rambuje të Francës. Konferenca filloi më 6 shkurt 1999. Atë e hapi presidenti francez, Zhak Shirak, i cili me një fjalim bravuroz inkurajoi dhe u uroi të pranishmëve punë të mbarë. Gjatë qëndrimit në Rambuje, delegacioni serb punonte ndaras dhe asnjëherë ky delegacion nuk u takua me atë të shqiptarëve.

Më 5 shkurt, delegacioni shqiptar ishte mbledhur dhe kishte arritur një marrëveshje parimore për tri pikat kryesore: e para, cilido që të ishte numri i anëtarëve të tij, do të ruhej ekuilibri në përfaqësimin e UÇK-së, LDK-së, LBD-së; e dyta, vendimet do të merreshin me konsensus të plotë, pa pëlqimin e njërit prej këtyre tre elementeve kryesore të delegacionit nuk do të kishte asnjë vendimmarrje; si dhe përcaktimi i shefit të grupit negociator. Delegacioni përbëhej prej 16 anëtarësh.

Në përbërje të delegacionit ishin: *Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Ramë Buja* dhe *Xhavit Haliti* përfaqësonin UÇK-në. Bënte pjesë edhe grupi nga LBD (Lëvizja e Bashkuar Demokratike): *Mehmet Hajrizi, Rexhep Qosja, Hydajet Hyseni* dhe *Bajram Kosumi*. Kurse LDK-ja në delegacion kishte përcaktuar: *Fehmi Aganin, Ibrahim Rugovën, Idriz Ajetin, Edita Tahirin* dhe *Bujar Bukoshin*. Në delegacionin bënin pjesë edhe dy përfaqësues të pavarur: *Blerim Shala* dhe *Veton Surroi*.

Me delegacionin shqiptar ishin edhe ekspertët: *Arsim Bajrami*, për çështje kushtetuese, *Enver Hasani*, për të drejtën ndërkombëtare, *Musa Limani* për ekonomi, *Sabaudin Komoni* për financa, *Avni Jarshellari* dhe *Sokol Bare* për çështjet e sigurisë, *Naip Zeka* për resurset natyrore, *Shenasi Rama* dhe *Xhavit Rexhaj* për çështje ndërkombëtare, *Agim Çeku* dhe *Adem Qopani* për çështje ushtarake. Delegacioni për këshillime kishte edhe ekspertë të shquar ndërkombëtarë, si: *Mark Weller*, ekspert i shquar i së drejtës ndërkombëtare dhe *Norton Amramoviç*, jurist i shkëlqyeshëm. Shqiptarët gjatë Konferencës komunikuan edhe me ekspertë të fushave të ndryshme.

Delegacioni i Kosovës pas marrjes së përkrahjes nga populli, më 13 mars u nis për ta nënshkruar Marrëveshjen në Paris. Kësaj here delegacioni ishte vendosur në hotelin “Sofitelj”, në qendër të Parisit. Që në fillim ndërmjetësit kishin bërë me dije se nuk do të lejohej që çështja të zgjatej si në Rambuje. Klinton për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pala shqiptare do të shprehet: *“Jam shumë i kënaqur që shqiptarët kanë rënë dakord që të nënshkruajnë marrëveshjen e paqes. Inkurajoj edhe zotin Millosheviq që ta bëjë të njëjtën gjë, por nëse serbët refuzojnë, nuk na mbetet ndonjë zgjidhje tjetër përveç forcës”*.

Kapitulli II:

Marrëveshja teknike-ushtarake, e cila u nënshkrua nga ana e Serbisë dhe NATO-s në Kumanovë, ishte hapi i dytë i rëndësishëm, që u ndërmor në vitin 1999 në çështjen e Kosovës. Kjo marrëveshje e 9 qershorit 1999 parashih tërheqjen e trupave serbe nga Kosova, si dhe paraqet planin e tërheqjes së tyre. Këtë marrëveshje e nënshkruan: komandanti i KFOR-it, gjeneral lejtant, Mike Jackson, përfaqësuesi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave, gjeneral kolonel, Svetozar Marjanoviç dhe përfaqësuesi i Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë, gjeneral lejtant, Obrad Stefanoviç.

Nënshkrimi i Marrëveshjes midis ushtrisë jugosllave dhe NATO-s shënoi fundin e bombardimeve ajrore të NATO-s dhe pranimin e kushteve që ajo i parashtroi Serbisë për njohje të kapitullimit dhe për tërheqjen e forcave të saj nga territori i Kosovës. Me rastin e arritjes së kësaj marrëveshjeje nuk është konsultuar asnjë nga subjektet politike dhe ushtarake shqiptare të Kosovës. Marrëveshja e Kumanovës përcakton modalitete tekniko-ushtarake të tërheqjes së forcave serbe nga territori i Kosovës dhe hyrja e forcave ndërkombëtare të sigurisë. Pas hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë, Këshilli i Sigurimit, më 10 qershor 1999 miratoi Rezolutën 1244 me të cilën edhe formalisht vendosi Kosovën nën administrimin e Kombeve të Bashkuara dhe hapi rrugën për vendosjen e pranisë ndërkombëtare civile dhe ushtarake në territorin e Kosovës. Marrëveshja përmban gjithsej 6 nene dhe dy shtesa. Në nenin e parë përcaktohen obligimet kryesore, ku pala serbe pajtohet për vendosjen e pranisë civile të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe pranimin nga ana e saj të vendosjes së Sigurimit Ndërkombëtar (KFOR).

Më 10 qershor 1999, pas miratimit të Rezolutës 1244, Këshilli i Aleancës së Atlantikut autorizoi hyrjen në Kosovë të trupave të KFOR-it, më 12 qershor 1999 në operacionin e quajtur “Mbrotësi i Përbashkët”. Kjo rezolutë i lejonte secilit shtet anëtar i OKB-së të vendosë trupa në Kosovë, praktikisht nënkuptohej që KFOR-i ishte e vetmja forcë ndërkombëtare pranishme. KFOR-i për ta lehtësuar ruajtjen e paqes, bëri ndarjen e territorit të Kosovës në pesë zona. Secila zonë ishte nën kontrollin e një shteti të vetëm të NATO-s.

Kështu veriu në Rajonin e Mitrovicës u vu nën kontrollin e Francës me 7000 trupa; jugu në Rajonin e Prizrenit ishte nën përgjegjësinë e Gjermanisë me 8000 trupa; Rajoni i Pejës në përfundim ishte nën kontrollin e Italisë me 6000 trupa, ndërsa zona qendrore përreth Prishtinës dhe pjesa lindore e Gjilanit ishte nën kontrollin e SHBA-ve me 8000 trupa. Zona e Ferizajt dhe e Vitisë ishin nën përgjegjësinë e Mbretërisë së Bashkuar me 6000 trupa.

Më 3 qershor 1999, Millosheviçi pranoi kushtet e një plani ndërkombëtar paqeje për të ndaluar luftimet, ku në kuvendin kombëtar po pranoheshin propozimet pavarësisht debateve të ashpra dhe përleshjeve me grushte në disa raste. Në 10 qershor Komiteti i Atlantikut të Veriut ratifikoi marrëveshjen dhe pezulloi operacionet ajrore.

Trupat e para të NATO-s që u futën në Prishtinë në 12 qershor 1999 ishin forcat speciale norvegjeze FSK Forsvarets Spesialkommando dhe forcat speciale ajrore britanike S.A.S. 22 Special Air Service, pavarësisht se trupat ruse ishin të pranishme më parë në aeroportin e Prishtinës. Ushtarët norvegjezë të FSK Forsvarets Spesialkommando ishin të parat që ranë kontakt me trupat ruse në aeroport. Misioni i FSK ishte të implementonte paqen ndërmjet palëve shqiptare dhe serbe.

Kapitulli III:

Në nëntor 2005 filloi zyrtarisht procesi për vendosjen e statusit përfundimtar të Kosovës. Kosova nga viti 1999, pasi që forcat serbe u detyruan ta lëshonin Kosovën, ka qenë e administruar nga misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara UNMIK, dhe institucionet demokratike të Kosovës: Kuvendi, Presidenti dhe Qeveria e Kosovës. Edhe pse Serbia nuk ka kontroll mbi Kosovën, në rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, disa herë përmendet se Kosova është protektorat i OKB-së, por juridikisht pjesë e Republikës Federale të Jugosllavisë. Sipas kësaj rezolute OKB ka përgjegjësin për administratën civile kurse NATO për sigurinë në Kosovë. Thuhet se shtetet mike të Kosovës në vitin 1999 donin që ta mos përfshinin në rezolutë fjalën Jugosllavi, por Rusia që ka të drejtë të vetës në Këshillin e Sigurimit, këmbënguli.

Kosova, në bazë të Rezolutës 1244 është nën Protektoratin (Administrimin civil, politik dhe ushtarak) të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, çka nënkupton Administrim të Përkohshëm të Kosovës nga kjo organizatë, e cila këtë e bënë me Misionin e saj në Kosovë të njohur me shkurtesën UNMIK. Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) udhëhiqet nga Autoriteti i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

Mirëpo, me kalimin e kohës, sipas Rezolutës 1244, UNMIK-u kishte për detyrë dhe i ndihmoi vendorët në krijimin e institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ), së pari me formimin e Këshillit të Përkohshëm Administrativ (KPA), ku ishin të përfaqësuara të gjitha grupet politike dhe bashkësitë etnike që jetojnë në Kosovë. Në vitin 2001 nxjerr Kornizën Kushtetuese të Kosovës, dokument i cili është miratuar me konsensus në mes të strukturave ndërkombëtare dhe UNMIK-ut në njërën anë dhe atyre vendorë të KPA-së. Në bazë të Kornizës Kushtetuese fillon ndërtimi i institucioneve vendore, si dhe funksionalizimi dhe demokratizimi i tyre nën mbikëqyrjen ndërkombëtare. Njihet e drejta për krijimin e institucioneve vetëqeverisëse, si ato qendrore, ashtu edhe ato lokale, përmes zgjedhjeve të lira dhe votës së lirë të qytetarëve për të dyja nivelet e pushtetit.

Trazirat e marsit (Serbisht: Мартовски погром / *Martovski pogrom*) është rasti më i keq i dhunës etnike në Kosovë që nga fundi i konfliktit 1999 shpërtheu në qytetin e ndarë të Mitrovicës, duke lënë qindra të plagosur dhe të paktën 14 njerëz të vdekur. Trazirat u përshpejtuan nga raporte mashtruese në mediet shqiptare të Kosovës që pretendonin në mënyrë të rreme se tre djem shqiptarë të Kosovës ishin mbytur pasi ishin ndjekur në lumin Ibër nga një grup serbësh të Kosovës. Paqeruajtësit e OKB-së dhe trupat e NATO-s u përpoqën të përmbajnë një betejë të ndezur me armë midis serbëve dhe shqiptarëve etnikë.

Më 5 tetor të vitit 2005, ambasadori Kai Aide ia prezantoi Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Kofi Anan, raportin e përpiluar për situatën dhe rreth situatës në Kosovë. Ky raport theksonte fillimin e dialogut për statusin e Kosovës. Pasi u prezantua raporti për Kosovën, Këshilli i Sigurimit i OKB-së diskutoi për këtë raport dhe më 24 tetor të vitit 2005 urdhëroi për fillimin e bisedimeve ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve për statusin final të Kosovës. Po ashtu, emëroi Marti Ahtisarin të dërguarin për negociatat për Kosovën.

Këshilli i Ministrave, rikonfirmoi vendosmërinë e BE-së që të angazhohet plotësisht në definimin e statusit final të Kosovës dhe në implementimin e plotë të saj. Më tej në deklaratën përfundimtare nga ky takim theksohej se statusi i ardhshëm duhet të jetë në përputhje me vlerat dhe normat evropiane, si dhe në harmoni me kartën e OKB-së. Gjithashtu, një pikë e rëndësishme ishte se marrëveshja për Kosovën duhej të sigurote që Kosova të mos kthehej në gjendjen e para marsit të vitit 1999.

Bisedimet, të cilat ishin të planifikuara të mbaheshin më 25 janar, u shtynë për muajin shkurt të vitit 2006, për shkak të vdekjes së presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova. Gjatë 15 rundeve të bisedimeve shqiptaro – serbe në Vjenë, bisedohej vetëm për çështje teknike, nga fusha e transportit, privatizimit, shëndetësisë, decentralizimit, personave të zhdukur, çështje këto që mund të bisedoheshin edhe pas zgjidhjes së statusit.

Faza finale e Rezolutës 1244 parashikonte zgjidhjen e statusit politik të Kosovës dhe për ta çuar punën deri në fund, ishte riaktivizuar Grupi i Kontaktit për Kosovën. Ministrat e Jashtëm të Grupit të Kontaktit, pjesë e të cilit ishte edhe ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, kishin përcaktuar tashmë në nëntor të 2005 tri parimet themelore për zgjidhjen e statusit final të Kosovës, që ishin: nuk ka kthim të Kosovës para vitit 1999, nuk ka ndarje të Kosovës dhe nuk ka bashkim të Kosovës me ndonjë vend tjetër.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës është bërë më 17 shkurt të vitit 2008 në orën 15:39 në Kuvendin e Republikës së Kosovës në Prishtinë. Në një mbledhje të jashtëzakonshme ku merrnin pjesë 109 nga gjithsej 120 deputetë, Kuvendi i Kosovës njëzëri shpalli Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik.

